



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
SEKTROI I BURIMEVE NJERËZORE

B.Curri, më _____. _____. 2018

SHPALLJE

**PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË
KATEGORINË EKZEKUTIVENE POZICIONIN**

Specialist i Burimeve Njerzore

Niveli i diplomës : Minimumi Master Profesional ,në **Shkenca Shoqerore,Inxhinjeri ose informatike.**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar,si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Tropojë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:**Specialist i Burimeve Njerëzore**

.Kërkohen 1 (nje) Specialistë në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Tropojë, kategoria e IV-a.

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.

Vetëm në rast se këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë vakante, atëherë janë të vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave për **LEVIZJE PARALELE: 29.01.2018**

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave për **PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 02.02.2018**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

1-Përcaktimi dhe vlersimi në bashkepunim me eproret dhe njësit e tjera organizative të institucionit i politikave të Burimeve Njerëzore dhe ndërtimit te institucionit duke patur në konsideratë objektivat strategjike te institucionit dhe orjentimet e politikave për menaxhimin e Burimeve njerëzore .

2-Menaxhimi i përditshem i burimeve njerëzore që nga emërimi deri në përfundimin e mardhenjeve të punës në institucion.

3-Ndjek dhe zbaton procedurat ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me rekrutimin, vlerësimin e rezultateve të punës, rregjistrimin e lëvizjes punonjëseve, menaxhimin e dosjeve të personelit dhe dhënjën e informacionit mbi indikatorët e menaxhimit të burimeve njerëzore.

4-Mbështet nevojat e veprimtarisë së institucionit me burime të kualifikuara njerëzore dhe kujdeset për zhvillimin e karrierës së tyre nëpërmjet kualifikimeve trajnimeve e tjerë.

5-Mbështet njesit organizative të institucionit në lidhje me proceset e parashikuara në legjislacionin për nepunësit civilë në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë, masat disiplinore dhe hartimin e pershkrimeve të punës.

6-Merr pjesë në procesin e hartimit të strukturës dhe organikes së institucionit

7- Hedh të dhënat e punonjëseve në rregjistrin qendror të personelit në përputhje me VKM nr.117 dt.5.03.2014“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të rregjistrimit qendror të personelit”.

8- Harton kontratat e punës punonjëseve që trajtohen me kod pune në përputhje me ligjin nr.7961 dt.12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

9-Kryen detyrat e ngarkuara nga eproret në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe raporton në kohë për realizimin e tyre.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nepunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

• KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nepunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të Nivelit master profesional në shkencë shoqërore ose informatike.
- Të ketë eksperiencë minimumi 1 vit
- Të kenë njohuri baze për programet kompjuterike

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Tropoje, dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://administrata.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

- Fotokopjet e diplomës masterit ose te barasvlefshme (përfshirë edhe diplomën bachelor),nese studimet jan kryer jashte shqiperis duhet sillet njehsimi I diplomes nga ministria e Arsimit dhe sporteve.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga Institucioni qe nuk ka masë disiplinore ne fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Tropojë, brenda datës **29.01.2018**

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **31.01.2018** njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Tropoje do të shpallë në stenden e informacinit Bashkise të institucionit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e verifikimit paraprake te kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzorete Bashkise Tropoje, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail). ndersa. Me dt.**08.02.2018** do të shpallet lista e verifikuar e kandidateve që plotësojn kriteret për vazhdimin e konkurimit, si dhe data,ora dhe vendi i testimit me shkrim dhe intervistes me goje per konkurentet e kualifikuar.

-FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTAKandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar dhe aktet nenligjore ne zbatim të tij.
- 3-Ligji 7961 dt.12.07.1995 Kodi i punes ne Repupliken e Shqiperise. i ndryshuar
- 4-Ligji nr 139/2015 dt.17.12.2015’per veteqeverisjen vendore”
- 5-Ligji 9131 dt.08.09.2003”Per rregullat e etikes ne Administraten Publike”
- 6-Ligji 9367 dt.07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktin e intertesit në ushtrimin e funksioneve publike
- 7-Ligjin nr. 139/2015 dt 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar. Kandidatët do të vlerësohen për pervojen, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al” <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

- **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për rezultatet e konkurrenteve dhe fituesin do të shpallet në stenden e informacionit të Bashkisë Tropojë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”

2.-PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive këtë informacion do ta merrni në stenden e informacionit Bashkis Tropojë dhe në “Portalin e shërbimit kombëtar të punësimit” duke filluar nga dt. **02.02.2018** e në vazhdim

2.1- KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formësë prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- 1-Të zotërojë diplomë të nivelit Master profesional ose të barasvlefshëm në shkencat Shoqerore, ose informatike.
- 2-Të ketë eksperiencë pune të paktën 1 vit
- 3-Të kenë njohuri baze në programet kompjuterike

2.2-DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://administrata.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) dhe listen e notave, nëse studimet janë kryer jashtë vendit duhet të dorzohet njesimi i diplomes nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- Vetëdeklarim që nuk është perjashtuar me masë disiplinore nga shërbimi civil
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar pranë zyres sekertari arkivit Bashkise Tropojë.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës **02.02.2018**

2.3-REZULTATET PËRFAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12.02.2018**, Bashkia Tropoje do të shpallë në Stenden e informacionit Bashkise Tropojë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e verifikimit paraparak të kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Tropojë, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail). ndersa lista e verifikuar e kandidateve që fitojn të drejtën për të konkuruar në testimin me shkrim do të shpallet në portalin kombëtar të punësimit dhe në stenden me **22.02.2018** në këtë datë do të njoftohet edhe data dhe ora e testimit me shkrim dhe me gojë në Portalin e shërbimit kombëtar dhe në stenden për informimin e publikut të Bashkisë.

2.4-FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar dhe aktet nenligjore ne zbatim te tijë.
- 3-Ligji 7961 dt.12.07.1995 i ndryshuar Kodi i punes ne Repupliken e Shqiperise.
- 4-Ligji nr 139/2015 dt.17.12.2015’per veteqeverisjen vendore”
- 5-Ligji 9131 dt.08.09.2003”Per rregullat e etikes ne Administraten Publike”
- 6-Ligji 9367 dt.07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktin e intertesit ne ushtrimin e funksioneve publike
- 7-Ligjin nr. 139/2015 dt 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”,”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 -MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVEKandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimi për testin me shkrim, deri në **60** pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **25** pikë;
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **15** pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6-DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

-Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në “portalin e shërbimit kombëtar të punësimit ” për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive:

-Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë të cilet nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

–Ndërsa kandidatët që kualifikohen , për të marrë informacionin e duhur, duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin e shërbimit kombëtar të punësimit” dhe Stenden e informacionit Publikut te Bashkise Tropojë, duke filluar nga data **12.02.2018** e në vazhdim.

- Në përfundim të konkurimit Bashkia Tropojë do të shpallë rezultatin e konkurrenteve dhe fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe Stenden e informimit publikut Bashkise Tropojë.

NJËSIA BURIMEVE NJERËZORE